Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/27
Datë: 29.01.2021

Në mbështetje të nenit 4 dhe 23 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës nr. 03/L-189, nenit 6 dhe 16 të Ligjit për Kualifikimet Kombëtare nr. 03/L-060, Udhëzimit Administrativ për Njohjen e Mësimit Paraprak (UA Nr. 31/2014, datë 05.09.2014), dhe Udhëzimit Administrativ për Kriteret dhe procedurat për akreditimin e institucioneve që zbatojnë njohjen e mësimit paraprak në Kosovë (UA Nr. 09/2019, datë 18.06.2019), Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 30.12.2020 nxjerrë këtë:

## V E N D I M

1. **Akreditohet** Qendra për Aftësim Profesional "Professional Beauty Academy", me adresë Bulevardi Bill Clinton, Prishtinë, Kosovë, për periudhën dy (2) vjeçare, përkatësisht nga data 30.12.2020 deri 29.12.2022, për zbatimin e Njohjes së Mësimit Paraprak (NjMP), me kualifikimin e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).

   1.1 **Parukeri**, Niveli III sipas KKK me 100 kredi të AAP. IAAP mund të përfshijë në procesin e NjMP deri 72 kandidatë brenda një viti.

2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së Qendrës për Aftësim Profesional "Professional Beauty Academy" për akreditim të zbatimit të NjMP dhe rekomandimeve të dala nga Raporti vlerësues i ekipit të ekspertëve për akreditim të institucioneve për zbatimin e Njohjes së Mësimit Paraprak (NjMP), u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për Akreditim të zbatimit të NjMP si institucion; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.

Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për akreditimin e institucioneve që zbatojnë njohjen e mësimit paraprak në Kosovë (UA Nr. 09/2019, datë 18.06.2019). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 30 ditësh nga momenti i pranimit nga Qendra për Aftësim Profesional "Professional Beauty Academy".

Vendimi u dërgohet:

1. Qendrës për Aftësim Profesional "Professional Beauty Academy"
2. Arkivit të AKK.

Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI

Kryetar i KD së AKK